



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

UDHËZUES PËR APLIKANTËT – ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE (OSHC-TË) NË KUADËR TË THIRRJES SË HAPUR PËR ALOKIMIN E FONDEVE PËR ORGANIZATAT SPORTIVE TË SHOQËRISË CIVILE PËR PROJEKT PROPOZIME NË PROGRAMIN RAJONAL PËR DEMOKRACINË VENDORE NË BALLKANIN PERËNDIMOR (ReLOaD)

Qëllimi i këtij udhëzuesi është të ofrojë këshilla të qarta dhe koncize për të gjitha organizatat e shoqërisë civile (OSHC) të interesuara në procesin e dorëzimit të projekt - propozimeve në kuadër të Thirrjes së hapur Publike për OSHC-të në Bashkinë Lezhë.

Qëllimi i dorëzimit të projekt-propozimeve për thirrjen publike është të ndihmojë në forcimin e partneritetit midis Shoqatave sportive dhe organeve të qeverisjes vendore përmes rritjes së ndërgjegjësimit për të mirat e bashkëpunimit si dhe nxitjes së një platforme të qëndrueshme për ofrim e shërbime më të mira në mbështetjetë zhvillimit të Sportit.

Bashkia Lezhë ka një bashkëpunim të gjatë dhe të suksesshëm me organizatat jo fitimprurëse në komunitetin tonë me qëllim realizimin e objektivave zhvillimore të Bashkisë Lezhë. Në këtë kuadër Bashkia Lezhë ka zbatuar me sukses metodologjinë LOD të Programit Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD).

Duke e konsideruar praktikën e metodologjisë LOD si një praktikë e mirë unifikuese, mbështetur në standartet e Bashkimit Evropian për menaxhimin e projekteve, Bashkia Lezhë angazhohet që alokimin e fondeve publike edhe për shoqatat sportive, pjesë e shoqërisë civile, ti realizojë sipas Metodologjisë LOD, miratuar me **VKB Nr. 211 datë 31/10/2017**.

1. ReLOaD dhe partneriteti me Bashkinë Lezhë

Qëllimi i përgjithshëm i programit ReLOaD është që të fuqizojë demokracitë pjesëmarrëse dhe procesin e integritetit në BE në Ballkanin Perëndimor, duke mbështetur shoqërinë civile që të jetë pjesë e proceseve të vendimmarrjes si dhe duke stimuluar dhe krijuar një mjedis ligjor dhe financiar inkurajues për të. Disa nga rezultatet që Bashkia Lezhë synon të arrij nëpërmjet Programit Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor - ReLOaD financohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatohet nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) janë:

Disa nga **rezultatet që Bashkia Lezhë synon të arrijë** në çdo partneritet me shoqatat sportive, pjesë e shoqërisë civile, janë:

- Përdorimi i modeleve transparente dhe të bazuara në projekte konkrete për financimin e shoqatat sportive, pjesë e shoqërisë civile:



- Ofrimi i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit të Sportit, nëpërmjet shoqatave sportive;
- Ngritja e kapaciteteve të shoqatave sportive, për të zbatuar skemat e grantit dhe ofruar projekte cilësore:
- Vënie në funksionim ose mbështetje e strukturave për veprimtari ose ngjarje sportive aktive; mbështetje për ekipet përfaqësuese vendore në veprimtaritë sportive kombëtare.
- Grante, hua ose financime për të mbështetur ekipe ose konkures në veprimtaritë sportive kombëtare.

2. SYNIMI I THIRRJES PUBLIKE PËR PROJEKT PROPOZIME DHE PRIORITETET VENDORE

Nëpërmjet kësaj Thirrjeje publike synohet forcimi i partneritetit ndërmjet organizatave të shoqërisë civile dhe njësisë të pushtetit vendor. Kjo do të arrihet nëpërmjet zbatimit të projekteve nga Shoqatat Sportive për të ofruar shërbime më të mira në mbështetje të zhvillimit të disiplinave sportive. Në këtë kuadër, ftohen të gjitha Shoqatat Sportive të interesuara të dorëzojnë projekt-propozime, të cilat duhet të adresojnë prioritetet strategjike të Bashkisë Lezhë në mbështetje financiare dhe zhvillim të fushave të përparësisë (disiplinave sportive):

- **Lojëra me dorë**
 1. Volejboll Femra
 2. Basketboll Meshkuj
- **Sporte Individuale**
 1. Atletikë
 2. Judo
 3. Boks
 4. Mundje
 5. Taekwondo
- **Futboll Meshkuj**
 1. Futboll Meshkuj

Fondet do t'i alokohen atyre shoqatave jofitimprurëse projektet e të cilave kontribuojnë në menaxhimin efikas të një apo më shumë disiplinave sportive si dhe që plotësojnë kriteret e cilësisë dhe kushte të tjera të kësaj thirrjeje publike, sikurse përcaktuar në këtë Udhëzues.

3. FONDET (GRANTET) QË JANË NË DISPOZICION PËR PROJEKTE

Vlera e granteve që ndahen si pjesë e kësaj thirrjeje publike duhet të jenë me shumat si më poshtë:

LOT 1

- shuma minimale: për Basketbollin 8,000,000 ALL.



- shuma maksimale: për Basketbollin 8,500,000 ALL.

LOT 2

- shuma minimale: për Futbollin 9,000,000 lekë ALL.
- shuma maksimale: për Futbollin 10,000,000 lekë ALL.

LOT 3

- shuma minimale: për Shumësportet ku duhet të përfshihen disiplinat (Atletike, Judo, Volejball, Boks, Taekwondo, Mundje) 2,500,000 ALL.
- shuma maksimale: për Shumësportet ku duhet të përfshihen disiplinat (Atletike, Judo, Volejball, Boks, Taekwondo, Mundje) 3,000,000 lekë ALL.

Shoqatat sportive të interesuara mund të bashkëfinancojnë projektet e tyre ose të sigurojnë një pjesë të fondeve nga donatorë të tjerë. Grantet e alokuara në kuadrin e kësaj thirrjeje publike duhet të financojnë shpenzime që kontribuojnë në mirëmbajtjen dhe administrimin e ekipeve sportive. Shoqatat sportive përfituese ruajnë identitetin e tyre ligjor dhe organizativ dhe, për qëllime përfaqësimi sportiv dhe promocional, gjatë pjesëmarrjes në garat kombëtare dhe ndërkombëtare, angazhohen të përdorin emërtimin dhe logon “**Bashkia Lezhë**” në përputhje me rregulloret përkatëse, duke kontribuar në zhvillimin e sportit në Lezhë.

Bashkia ka të drejtën për të mos ndarë të gjitha fondet në dispozicion nëse projekt-propozimet që dorëzohen nga OSHC nuk i përmbushin kriteret e kërkuara.

Grantet e alokuara në këtë thirrje publike mund të mbulojnë shpenzimet e personelit deri në masën 30 % të shumës së kërkuar. Ndërsa, pjesa tjetër prej 70% të fondeve, duhet të parashikohen për aktivitete programore të projektit.

Shënim: Për rastet kur Shoqatat Sportive deklarojnë se do të bashkëfinancojnë, ky bashkëfinancim duhet të pasqyrohet në pjesën përshkrimore të projektit (shtojca 7), në aktivitete dhe në pjesën e buxhetit (shtojca 8).

4. KUSH MUND TË APLIKOJË

Pjesëmarrja në këtë thirrje publike është e hapur dhe e barabartë për shoqatat sportive që janë të regjistruara zyrtarisht në Shqipëri dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Për të aplikuar në thirrjen publike, aplikanti duhet të jetë një entitet ligjor jo-fitimprurës i regjistruar në Shqipëri në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe Ligjin 79/2017 ‘Për Sportin’, i ndryshuar.

Shoqatat Sportive do të përjashtohen nga pjesëmarrja në thirrje apo nga ndarja e granteve nëse në kohën e dorëzimit të projekt propozimeve:

- janë degë/zyra të organizatave dhe fondacioneve ndërkombëtare, dhe organizatat të tjera ndërkombëtare jo-fitimprurëse të regjistruara për të punuar në Shqipëri;
- janë subjekt i ndonjë konflikti të interesit, sikurse parashikuar në dispozitat e Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e



funksioneve publike”. Më konkretisht, përjashtohen nga vlerësimi ato projekte, në të cilat: *Drejtori ekzekutiv, anëtarët e bordit apo personat e planifikuar për tu përfshirë në projekt janë të punësuar në bashkinë apo institucionet e saj të vartësisë në të cilën aplikohet, në pozicionet: Zyrtaari i nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues sipas legjislacionit të shërbimit civil¹ si dhe anëtar i Këshillit Bashkiak, anëtar i kabinetit të Kryetarit të Bashkisë.*

- janë fajtorë për dhënien e informacionit të rremë një pale kontraktuese të autorizuar, që kërkohet si parakusht për pjesëmarrje në thirrjen për dorëzimin e projekt-propozimeve ose nëse nuk dorëzojnë informacionin e kërkuar;
- janë përpjekur të sigurojnë informacion konfidencial, të ushtrojnë ndikim mbi Komisionin e Vlerësimit ose mbi një palë të autorizuar kontraktuale gjatë procesit të vlerësimit të projekt-propozimit;
- nuk kanë dorëzuar të gjitha dokumentet e nevojshme sipas pikës 8;
- vlera e buxhetit të propozuar nuk është në përputhje me kërkesat e thirrjes;
- kohëzgjatja e propozuar e projektit është jo më e shkurtër se 6 muaj dhe jo më e gjatë se 12 muaj në vit;
- Subjekti aplikues nuk duhet të ketë detyrime të papaguara vendore, detyrime të ngarkuara nga organet kompetente audituese apo detyrime të ngarkuara nga organe të tjera në favour të Bashkisë Lezhë. Mos përmbushja e këtij kriteri është shkak skualifikimi.

Në rast miratimi të projektit, do të kërkohen të paraqiten dokumentet origjinale.

5. KOHËZGJATJA

Projektet e përzgjedhura duhet të zbatohen në periudhën: 6 muaj – 12 muaj.

6. VENDI I ZBATIMIT

Projektet duhet të zbatohen në territorin e Bashkisë Lezhë.

7. LLOJET E PROJEKTEVE

- Projekt-propozimet që do të financohen nga kjo thirrje duhet të jenë të përgatitura në përputhje me thirrjen publike duke ju referuar fishe projekteve të buxhetit vjetor të Bashkisë Lezhë.
- Projektet duhet të ofrojnë zgjidhje për nevojat specifike të disiplinave sportive dhe grupeve të targetuara të identifikuar nga projekti.
- Projektet duhet të jenë paketa veprimtarish të integruara dhe metodologjike, të krijuara për të arritur qëllime të caktuara dhe rezultate specifike në kuadër të një periudhe të kufizuar kohore, duke respektuar kalendarin vjetor të aktiviteteve sportive.

¹Neni 31 i Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, indryshuar “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.



Shoqatat Sportive mund të aplikojnë me një ose disa disiplina sportive. Në rastin e dy ose më shumë projekt propozimeve, shoqata sportive duhet të dorëzojë formulare aplikimi të veçante dhe për secilin aplikim duhet të dorëzohet dokumentacioni përkatës.

Aktivitetet në vijim nuk rekomandohen për ndarjen e granteve:

- Aktivitetet e rregullta të organizatës aplikuese apo organizatës partnere;
- Sponsorizimet individuale për pjesëmarrje në seminare, konferenca, kongrese;
- Bursat individuale për studime apo kurse trajnimi;
- Konferenca të herëpashershme (përveç nëse janë të nevojshme për zbatimin e suksesshëm të projektit);
- Financimi i projekteve që tanimë janë në proces ose kanë përfunduar;
- Projektet për përfitime ekskluzive të individëve;
- Projektet që mbështesin partitë politike;
- Ndarjen e granteve për palë të treta.
- Blerja e pajisjeve përveç rasteve kur janë patjetër të domosdoshme dhe brenda limiteve të shprehura në pikën 3 të Udhëzuesit.

Aktivitet e sipërpërmendura **NUK** janë shkak për refuzimin automatik të projekt - propozimit, megjithatë do të ndikojnë negativisht në vlerësimin e projekt propozimit. Gjithashtu, nëse projekt – propozimi aprovohet për financim, aktivitete të tilla dhe fondet e parashikuara për to do të eliminohen.

8. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR TË APLIKUAR

I. Dokumentet kryesore:

- Projekt propozimi (në formatin Word - Shtojca 7)
- Buxheti (formati Excel - Shtojca 8)
- Matrica e kornizës logjike (formati Word – Shtojca 9)
- Plani i aktiviteteve dhe dukshmërisë (Shtojca 10)

II. Dokumente shtesë (për organizatën aplikuese dhe partnerët, nëse ka)

- Vendimi i regjistrimit të organizatës në Gjykatë dhe ekstrakt i 3 muajve të fundit.
- Kopja e statutit të organizatës (për organizatën aplikuese dhe partnerët, nëse ka),
- Formulari i kompletuar identifikues administrativ dhe financiar (formati ëord– Shtojca 11),
- Deklarata e plotësimit të kriterëve (formati Word – Shtojca 12)
- Kopje e Pasqyrave financiare të OSHC-së (a. bilanci; b. PASH; c. cash flow; ç. shënimet shpjeguese) për vitin 2024 të firmosur nga një kontabilist i miratuar ose financieri zyrtar i OSHC-së sipas kriterëve ligjore në fuqi.
- Një raport përshkruar i projekteve dhe aktiviteteve të OSHC për vitin paraardhës, përveç rasteve nëse organizata është themeluar gjatë këtij viti.
- Deklarata e partneritetit në rast se OSHC aplikuese ka partnerë (shtojca A).
- Deklarata e shmangies së konfliktit të interesit (shtojca B).



- Vertetimi se kanë paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku janë të regjistruar.
- Dëshmi Penaliteti / Drejtori Ekzekutiv.

Shënim: Me qëllim vlerësimin e projekt – propozimit, dokumentacioni kryesor dhe ai shtesë janë njësoj të vlefshme dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të sipër përmendura në 3 kopje është i detyrueshëm.

9. KUR DHE KU TË MERRET DHE TË DORËZOHET PAKETA E APLIKIMIT

Dokumentacioni për thirrjen publike për Bashkinë e Lezhë mund të tërhiqet prej **19/02/2026 (dita e hapjes së Thirrjes Publike)** deri në **20/03/2026 (dita e mbylljes së Thirrjes Publike)** duke e dërguar një kërkesë me emrin e organizatës së interesuar në e-mail adresën: arsimirinia@lezha.gov.al apo personalisht, në adresën:

DREJTORIA E ARSIMIT, RINISË DHE SPORTEVE
KODI POSTAR 4501, SHESHI “GJERGJ KASTRIOTI”

Informacioni përkatës si dhe një version elektronik i të gjithë paketës së aplikimit mund të merret edhe nga faqja e internetit: <https://lezha.gov.al/>

Aplikimet e plotësuara me të gjithë dokumentacionin, duhet të dorëzohen **në tri (3) kopje të shtypura dhe në një kopje elektronike (në CD apo USB)** përmes postës zyrtare apo personalisht, të vendosura në një zarf të vulosur që i referohet thirrjes publike, gjatë ditëve të punës (prej të hënës deri të premten), nga ora 09:00 deri në ora 14:00, në adresën:

DREJTORIA E ARSIMIT, RINISË DHE SPORTEVE
BASHKIA LEZHË
KODI POSTAR 4501, SHESHI “GJERGJ KASTRIOTI”

Afati për dorëzimin e aplikimeve është 20.03.2026 (4 javë) nga data e hapjes së Thirrjes Publike). Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të jenë shkruar :

1. Emri i thirrjes publike për projekt- propozime;
2. Emri i plotë dhe adresa e aplikantit;
3. Emri i plotë i projektit në të cilin po aplikoni.
4. Fjalët: **“Të mos hapet përpara hapjes zyrtare”**.

Aplikimet e dërguara në mënyra tjera (p.sh. me faks apo e-mail) ose që janë dërguar në adresa tjera nuk do të merren parasysh.



Bashkia do të regjistrojë çdo aplikim të marrë në dorëzim dhe do të lëshojë vërtetimin përkatës (datën dhe orën e pranimit të projekt-propozimit).

10. INFORMACION TJETËR

1. Me qëllim mbështetjen e OSHC-ve për të paraqitur aplikime në përputhje me kriteret e Udhëzuesit, Bashkia do të organizojë takime informuese/ ditë të hapura do të organizohet me datë 03/03/2026, pranë ambienteve të Bibliotekës “ Gjergj Fishta” Lezhë, salla kati i 2-të, ora 11:00.
2. Pyetje rreth ftesës publike mund të behën përmes e-mail adresës arsimirinia@lezha.gov.al duke iu referuar thirrjes publike. Pyetjet mund të dërgohen deri më 13/03/2026 ndërsa përgjigjet do të jepen me shkrim brenda 5 ditëve pune që nga data e pranimit të pyetjeve përkatëse. Për qëllime transparence, përgjigjet mund t’u dërgohen gjithashtu të gjithë aplikantëve të mundshëm me email.

11. VLERËSIMI DHE PËRZGJEDHJA E PROJEKT-PROPOZIMEVE

Vlerësimi

Aplikimet do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga Komisioni i Vlerësimit, i cili përbëhet nga përfaqësues të Bashkisë Lezhe dhe përfaqësuesi i shoqërisë civile ose i Shoqatave sportive.

Shënim: Shoqata Sportive, përfaqësuesi i së cilës është anëtari i Komisionit të vlerësimit në cilësinë e përfaqësuesit të shoqërisë civile, nuk ka të drejtë të aplikojë në këtë thirrje as si aplikant kryesor dhe as si partner. Përfaqësuesi i shoqërisë civile në cilësinë e anëtarit të Komisionit të vlerësimit, zgjidhet me një proces të hapur dhe konkurrues.

Aplikimet do të vlerësohen në bazë të:

(i) *Kritereve administrative:*

- Aplikimi është dorëzuar brenda afatit, specifikuar në seksionin 10 të këtij Udhëzuesi;
- Aplikimi është i kompletuar sipas kërkesave të seksionit nr. 9;
- Dokumentacioni është dorëzuar në 3 kopje të shtypura dhe në një kopje elektronike (CD apo USB).
- Konfirmimi se organizata aplikuese, partneri (dhe bashkëpunëtorët, nëse ka ndonjë) dhe aktivitetet i përmbushin kushtet e specifikuara në seksionet 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8 (të përcaktuara më sipër).

(ii) *Kritereve të përmbajtjes/vlerësimi i cilësisë së projektit dhe vlerësimi financiar:*

Vlerësimi i cilësisë së projektit, përfshirë edhe buxhetin e propozuar, do të bëhet në përputhje me kriteret e specifikuara në Tabelën Vlerësuese që është pjesë përbërëse e këtij dokumenti.

Sistemi i vlerësimit është si më poshtë:

Kriteret e vlerësimit ndahen në seksione dhe nën-seksione: *Secili nën-seksion duhet të vlerësohet me pikët e*



caktuara nga 1 në 5, në këtë mënyrë: 1= shumë keq; 2= keq; 3= pranueshëm; 4= mirë; 5= shumë mirë. Secili anëtar i komisionit plotëson një tabelë individuale vlerësuese dhe të gjithë anëtarët e nënshkruajnë tabelën vlerësuese përmbledhëse për secilin projekt propozim. Radhitja e projekt propozimeve bëhet në atë mënyrë ku projekt propozimi i radhitur si i pari është ai i cili ka fituar numrin më të lartë të pikëve deri tek projekt propozimi me numrin më të ulët të pikëve.

- Pikët maksimale të vlerësimit për një projekt – propozim janë 100;
- Projektet të cilat aplikojnë për një shumë granti nga : **8,000,000 ALL - 10,000,000 All ALL**, do të meren në konsideratë për dhënien e grantit vetëm nëse vlerësohen me më shumë se **80 pikë**.
- Projektet të cilat aplikojnë për një shumë granti nga **2,500,000 All – 3,000,000 All** do të meren në konsideratë për dhënien e grantit, vetëm nëse vlerësohen me më shumë se **60 pikë**;

Vendimi për aprovimin e grantit mbështetet mbi numrin e përgjithshëm të projekteve që mund të financohen me buxhetin në dispozicion. Projektet që kanë fituar numër më të madh të pikëve do të kenë prioritet gjatë dhënies së granteve.

Shënim për Seksionin 1/Tabela e Vlerësimit: Kapaciteti financiar dhe operativ i organizatës aplikuese

Për të kaluar për vlerësim të mëtejshëm, projekti duhet të vlerësohet me 10 ose më shumë pikë, në seksionin 1. Kjo nënkupton që organizatat kanë në dispozicion buxhet të mjaftueshëm për financimin e aktiviteteve të rregullta gjatë gjithë periudhës së zbatimit të projektit si dhe kanë aftësi profesionale dhe kualifikime të cilat janë të domosdoshme për zbatimin e suksesshëm të projektit. E njëjta vlen si për organizatën aplikuese ashtu edhe për partnerët.

Projekti përjashtohet nga procesi i mëtejshëm i vlerësimit në rast se numri total i pikëve në Seksionin 1 është më i ulët se 10 pikë.

Shënim për Seksionin 2/Tabela e Vlerësimit: Relevanca

Për të kaluar për vlerësim të mëtejshëm, projekti duhet të vlerësohet me 15 ose më shumë pikë, në seksionin 2. Kjo nënkupton që projekti duhet të jetë relevant me qëllimin e thirrjes publike dhe fushat prioritare, cilësia e projektit, rezultatet e pritshme dhe qëndrueshmëria e projektit janë të konsiderueshme si dhe fondet që kërkohen janë në përputhje me aktivitetet e parashikuara.

Projekti përjashtohet nga shqyrtimi i mëtejshëm në rast se numri total i pikëve në Seksionin 2 është më i ulët se 15 pikë, sepse pikët tregojnë se megjithëse aplikanti i ka kapacitetet financiare dhe operative, koncepti i projektit nuk është relevant apo në përputhje me përparësitë e përcaktuara në thirrjen publike / projekti nuk trajton nevojat e komunitetit.

Seksioni	Pikët maksimale	Pikët mesatare
1. Kapacitetet financiare dhe operative	15	
1.1 A kanë aplikanti dhe partnerët përvojë të mjaftueshme në menaxhim projektesh? Vlerësim maksimal marrin organizatat që kanë të paktën 3 projekte të zbatuara apo në zbatim	5	
1.2 A kanë aplikanti dhe partnerët kapacitete të mjaftueshme profesionale? (njohuri specifike në fushën relevante) Vlerësim maksimal marrin organizatat të cilat kanë zbatuar të paktën 3 projekte në fushën për të cilën aplikojnë.	5	
1.3. A kanë aplikanti dhe partnerët kapacitete të mjaftueshme menaxhuese? (përfshirë personelin, pajisjet dhe kapacitetet për menaxhim financiar)? Vlerësim maksimal marrin organizatat të cilat kanë zbatuar të paktën 3 projekte me shuma mbi 10.000 Euro.	5	
2. Relevanca	25	



2.1. Sa relevant është projekti krahasuar me synimin dhe me një apo më shumë disiplina sportive të përcaktuara në thirrjen publike? Shënim: 5 pikë (shumë mirë) mund të jepen vetëm nëse projekti trajton të paktën njëri prej përparësive të bëra publike në thirrjen e shpallur.	5	
2.2 A janë palët e interesuara të përcaktuara qartë dhe të përzgjedhura në mënyrë strategjike (bashkëpunëtorët, përfituesit përfundimtarë, grupet e synuara)?	5	
2.3 A janë nevojat e grupit të synuar dhe përfituesve përfundimtarë të përcaktuara qartë dhe a i trajton projekti ato në mënyrën e duhur?	5	
2.4 A përfshin projekti vlerë të shtuar, si qasje inovative dhe modele të praktikës së mirë? Vlerësim maksimal marrin aplikimet të cilat sjellin risi në zbatimin e projekteve në bashkinë përkatëse.	5	
2.5 A bën projekti avokim për një qasje të bazuar tek të drejtat dhe a ka ndikim pozitiv tek grupet e pafavorizuara? (Promovimi i barazisë gjinore dhe i fuqizimit të grave, mbrojtja e mjedisit, bashkëpunimi ndërkombëtar, rinia, etj.) Vlerësim maksimal marrin aplikimet, të cilat ndikojnë në të paktën 2 grupe të marginalizuara.	5	
3. Metodologjia	20	
3.1 A përshtaten plani i aktiviteteve dhe aktivitetet e propozuara në mënyrë logjike dhe praktike me qëllimet dhe rezultatet e pritshme?	5	
3.2 Sa konsistente është skema e përgjithshme e projektit? (veçanërisht, a e pasqyron analizën e problemeve të identifikuar, faktorët e mundshëm të jashtëm) Vlerësim maksimal marrin aplikimet, në të cilat janë marrë në konsideratë faktorët e jashtëm (sipas logframe) dhe janë prezantuar masa për eliminimin e tyre.	5	
3.3 A është i kënaqshëm niveli i përfshirjes së partnerëve në zbatimin e projektit? Shënim: nëse nuk ka asnjë partner pikët e përfituara do të jenë 1. Këtu nuk përfshihen bashkëpunëtorët.	5	
3.4 A janë përfshirë në projekt tregues objektivisht të matshëm? Vlerësim maksimal marrin aplikimet, të cilat në logframe kanë indikatorë të qartë e të matshëm.	5	
4. Qëndrueshmëria	25	
4.1 A do të kenë veprimtaritë e propozuara ndikim konkret tek grupet e synuara? Vlerësim maksimal marrin aplikimet të cilat lidhin aktivitetet e propozuara me grupet e synuara.	5	
4.2 A do të ketë projekti ndikime të shumëfishta? (përfshirë mundësinë e zbatimit në grupe të tjera të synuara ose në vende të tjera dhe/ose shtrirjen e ndikimit të veprimtarive si dhe shkëmbimin e informacionit për përvojën e fituar gjatë zbatimit të projektit)	5	
4.3 A janë rezultatet e pritshme të veprimtarive të sugjeruara të qëndrueshme nga ana institucionale? (a do të ekzistojnë strukturat që mundësojnë veprimtaritë e projektit pas përfundimit të projektit? A do të ketë pronësi lokale mbi rezultatet e projektit?)	5	
4.4 A janë rezultatet e pritshme të qëndrueshme? (aty ku është rasti, përmendin ndikimin strukturor të veprimtarive të zbatuara – përmirësime në kuadrin ligjor, metoda, kodin e sjelljes, etj.)	5	
4.5 A ka mundësi që rezultatet/arritjet e pritshme afatgjata do të ndikojnë në kushtet ekonomike lokale dhe/ose cilësinë e jetës në zonën e synuar?	5	
5. Buxheti dhe efikasiteti i kostos	15	
5.1 A është i kënaqshëm raporti ndërmjet shpenzimeve të parashikuara dhe rezultateve të pritshme? Vlerësim maksimal marrin aplikimet të cilat kanë respektuar ndarjen e % së aktiviteteve sipas udhëzuesit.	5	
5.2 A është kostoja e sugjeruar e nevojshme për zbatimin e projektit?	5	
5.3 Buxheti - a është buxheti i qartë dhe a përfshin edhe pjesën përshkruese? (përfshirë shpjegimet për pajisjet teknike) - a përmbushet parimi që kostoja administrative dhe e personelit nuk mund të jetë mbi 20 për qind e buxhetit total? - a është buxheti me ndjeshmëri gjinore? - a janë përfshirë CV-të dhe përshkrimet e punës, aty ku është e nevojshme?	5	
Pikët totale maksimale	100	

Njoftimi rreth vendimit

Në çdo rast, nëse projekt-propozimet miratohen për financim apo jo, të gjithë aplikantëve u njoftohet me shkrim vendimi për projekt-propozimin e tyre brenda 30 ditë pune nga mbyllja e thirrjes publike. Rezultatet shpallen në faqen e internetit të Bashkisë Lezhë (www.lezha.gov.al) si dhe në tabelën e njoftimeve të bashkisë.



Vendim për refuzimin e projekt-propozimit apo për mosdhënie fondesh merret nëse:

- Aplikanti ose një apo më shumë nga partnerët e tij nuk plotësojnë kriteret e thirrjes publike;
- Veprimtaritë e projektit janë të papranueshme (për shembull, veprimtaritë e propozuara shkojnë tej fushëveprimin të thirrjes publike për projekt-propozime, kohëzgjatja e parashikuar për projektin e kalon maksimumin periudhës kohore të lejuar, shuma e fondeve të kërkuara e kalon shumën maksimale të lejuar ose është më e ulët se minimumi, etj.);
- Projekt-propozimi nuk ka relevancë të mjaftueshme; kapacitetet financiare dhe operative të aplikantët nuk janë të mjaftueshme, ose projektet e tjera që u përzgjedhën për financim kishin epërsi në këto fusha;
- Cilësia e projekt-propozimit ishte më e ulët teknikisht dhe financiarisht në krahasim me projektet e përzgjedhura për financim.

Kushtet rreth zbatimit të projektit pas miratimit të grantit

Pas marrjes së vendimit për miratimin e grantit, organizatës së shoqërisë civile, projekti i së cilës është miratuar, i ofrohet një kontratë për zbatimin e projektit. Referuar metodologjisë LOD, para se të nënshkruajë kontratën dhe nëse është e nevojshme, Bashkia Lezhë ka të drejtën ti kërkojë organizatës modifikime të caktuara në projekt (buxhet apo aktivitete) për ta harmonizuar atë me rregullat dhe procedurat e zbatimit të projektit, pa cenuarhelbin e project propozimit.

LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 7 Projekt Propozimi

Shtojca 8 Buxheti

Shtojca 9 Korniza Logjike

Shtojca10 Plani i Aktiviteteve dhe dukshmërisë

Shtojca11 Formulari i identifikimit administrativ dhe financiar

Shtojca12 Deklarata e plotësimit të kriterëve

Shtojca A Deklarata e partneritetit

Shtojca B Deklarata për shmangien e konfliktit të interesit

